



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 434 Prot.

Gjirokastrë, më 08/04/2022

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Maçeratës, Itali.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Macerates ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:
3 pozicione për staf akademik për një periudhën një javore (nga e hëna në të premte).
3 pozicione për staf teknik për një periudhën një javore (nga e hëna në të premte).

Gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose italisht në nivelin B2 për stafin akademik dhe atë teknik. Sipas të dhënave nga Universiteti i Macerates, aplikimet janë të hapura për fushën e menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore.

Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **13.04.2022**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në shqip dhe në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze / italiane sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës së Universitetit të Macerates, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

